



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada- Government

2013-2016

**STRATEGJIA PËR KONTROLLIMIN DHE
MBLEDHJEN E ARMËVE TË VOGLA DHE TË
LEHTA DHE PLANI I VEPRIMIT I REPUBLIKËS
SË KOSOVËS**

2013, Prishtinë



**STRATEGJIA PËR KONTROLLIMIN DHE MBLEDHJEN E ARMËVE TË
VOGLA DHE TË LEHTA DHE PLANI I VEPRIMIT I REPUBLIKËS SË
KOSOVËS
2013-2016**

PËRMBAJTJA

AKRONIMET	5
I. PARATHËNJE	6
II. VIZIONI DHE MISIONI	8
III. METODOLOGJIA	9
IV. PARIMET E PËRGJITHSHME	10
4.1 Parimi i kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë	10
4.2 Parimi i mbrojtjes së të drejtave të njeriut	10
4.3 Parimi i kujdesit shëndetësorë	10
4.4 Parimi i Garantimit të sigurisë për të gjithë qytetarët	10
4.5 Parimi i vazhdimësisë	10
4.6 Parimi i përfshirjes	10
4.7 Parimi i ndarjes së përvojave dhe përgjegjësive dhe qasja e përbashkët	11
4.8 Parimi i të drejtës për t'u informuar	11
V. MEKANIZMAT LIGJORË	12
VI. OBJEKTIVAT KRYESORE DHE LIDHJA ME FUSHAT FUNKSIONALE	13
6.1. Hyrjet dhe furnizimet ilegale do të pengohen përmes zbatimit të përmirësuar	13
6.2. Deri në vitin 2016, kërkesa për armë, municion dhe eksplozivë do të zvogëlohet për 20 përqind në popullatën e Kosovës	13
6.3. Do të sigurohet hetim dhe dënim më efikas dhe i një cilësie më të lartë, e krimit me armë përmes bashkëpunimit, koordinimit dhe ndihmës së dyanshme	13
6.4. Deri në vitin 2016, palët e interesit do të kanë njohuritë, kushtet dhe burimet e nevojshme për të zbatuar metodat e përmirësuara të kontrollimit dhe mbledhjes së Armëve të Vogla dhe të Lehta.	13
VII. MEKANIZMAT INSTITUCIONAL	14
7.1. Koordinator kombëtar	14
7.2. Sekretariati	14
7.3. Ministria e Punëve të Brendshme – Policia e Kosovës	15
7.4. Roli Ministrisë së Drejtësisë	15
7.5. Roli i Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave – Doganat e Kosovës	16
7.6. Roli i Ministrisë së Shëndetësisë	16
7.7. Ministria e Edukimit, Shkencës dhe Teknologjisë	16
7.8. Ministria e Tregtisë dhe Industrisë	16
7.9. Komisioni i pavarur për mina dhe minerale	16
7.10. Ministria e Administratës së Pushtetit Lokal	16
7.11. Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinorë	17
7.12. Zyra e Prokurorit në Kosovë	17
7.13. Zyra e Statistikave e Kosovës	17

7.14. Ministria e Forcës së Sigurisë	17
7.15. Ministria e Punëve të Jashtme	17
7.16. Agjencioni Kosovar i Inteligjencës	17
7.17. Ministria e bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural	17
7.18. Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit	17
7.19. Agjencia Kosovare e Forenzikës	18
VIII. BBASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR	18
IX. IMPLEMENTIMI, MONITORIMI DHE VLERËSIMI I STRATEGJISË	18
9.1 Roli i sistemit të monitorimit	18
9.2 Kapacitetet institucionale për monitorim dhe vlerësim	18
9.3 Përzgjedhja e indikatorëve për monitorim dhe vlerësim, indikatorët final	19
9.4 Indikatorët e ndërmjetëm	19
9.5 Instrumentet e monitorimit dhe vlerësimit	19
9.6 Shpërndarja dhe përdorimi i rezultateve të monitorimit dhe vlerësimit	20
X. PLANI I VEPRIMIT	20

AKRONIMET

MPB	Ministria e Punëve të Brendshme
MFE	Ministria e Financave dhe Ekonomisë
MD	Ministria e Drejtësisë
MTI	Ministria e Tregtisë dhe Industrisë
MBPZHR	Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
MPMS	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
AKI	Agjencia Kosovare e Inteligjencës
MASHT	Ministria e Edukimit Shkencës dhe Teknologjisë
MKRS	Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit
MSH	Ministria e Shëndetësisë
MPJ	Ministria e Punëve të Jashtme
PK	Policia e Kosovës
AKF	Agjencia e Kosovës për Forenzikë
DK	Doganat e Kosovës
KGJK	Këshilli Gjyqësorë i Kosovës
UNDP	Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara
OSCE	Organizata për Bashkëpunim dhe Siguri në Evropë
KE	Këshilli i Evropës
OJQ	Organizatrat Jo-qeveritare
AVL	Armët e Vogla dhe të Lehta

I .PARATHËNJE

Në tërë botën vlerësohet se janë në qarkullim rreth 875 milion armë të vogla, prej të cilave rreth 650 milion vlerësohen të janë pronë private, 200 milion u takojnë forcave të mbrojtjes dhe rreth 20 milion agjencive për zbatimin e ligjit. Si në shumicën e vendeve të botës, në Kosovë shteti nuk është bartësi primar i armëve; janë civilët. Ndërkombëtarisht është vërtetuar se është shumë e vështirë të dihet numri i saktë i armëve ilegale në vend si dhe shumë organizata kanë ofruar studime apo kanë bërë një vlerësim të armëve ilegale në Kosovë por kurrë nuk ka pasur dakordim për një shifër definitive.

Megjithatë, disponueshmëria e armëve ilegale dhe trajtimi i tyre në shoqëri është i lartë, dhe, më së shumti demonstron me konfiskimin e rreth 2 deri 3 armë në ditë nga Policia e Kosovës. Për më tepër, shumica e këtyre armëve ruhen nëpër shtëpi. Sipas hulumtimit ndërkombëtarë, një armë në shtëpi më shumë ka gjasa të përdoret për ngacmim apo për lëndim fizik të familjarëve se sa për t'u përdorur kundër një të huaji të paftuar. Shenja më evidente e posedimit të armëve në Kosovë është qitja me armë në festa, e që arrin kulmin gjatë muajve të verës (martesat) dhe festimet e vitit të ri. Gjatë festimeve të tjera të rastit, qitjet me armë mund të dëgjohen rregullisht.

Që t'i përgjigjet këtij kërcënimi, Ministria e Punëve të Brendshme ka zbatuar kontrollimin e AVL-ve, strategjinë e koleksionimit dhe planin e veprimit që nga viti 2008, si përgjigje e parë e integruar e këtij problemi. Ky plan i veprimit ka krijuar një kornizë institucionale dhe ligjore në lidhje me këtë çështje, si dhe ofron elemente të ngritjes së kapaciteteve dhe të shkëmbimit të eksperiencës, të mjeteve dhe tëshërbimeve teknike për t'ju kundërvënë këtij lloji të krimin. Strategjia pati për qëllim të adresojë furnizimin si dhe kërkesën për AVL-të.

Strategjia për Armët e Vogla dhe të Lehta (AVL) e Republikës së Kosovës përqendrohet në të gjitha aspektet e Armëve të Vogla dhe të Lehta për qytetarët, si dhe për zbatimin e ligjit. Qëllimi kryesor i kësaj qasjeje të integruar është të ketë kontroll të PLOTË mbi Armët e Vogla dhe të Lehta në pajtueshmëri me standardet e KB-së, BE-së dhe OSBE-së.

Kjo strategji, e pranon që kontrolli i plotë ndaj armëve të vogla dhe municionit mund të arrihet vetëm nëpërmjet zbatimit të ligjit, andaj, përfshin komponentin e zvogëlimit të theksuar të kërkesës që synon mbështetjen nga popullata civile. Për më tepër, kjo strategji parasheh ndalimin e transportit të armëve dhe municionit ilegal brenda dhe jashtë vendit, por gjithashtu adreson edhe furnizimin ilegal me armë në vend (posedimi ilegal).

Një komponent tjetër vital për të arritur qëllimin tonë për kontrollimin e armëve të vogla dhe të lehta është partneriteti me agjencitë tjera për zbatimin e ligjit. Kjo nënkupton përmirësimin dhe zgjerimin e koordinimit dhe të partneritetit tonë në nivel kombëtarë, rajonal dhe atë global.

E fundit, por jo më pak e rëndësishme, do të kërkohet që ne të koncentrojmë burimet tona të limituara, sa më shumë që të jetë e mundur, në zbatimin cilësorë të operimeve që synojnë zvogëlimin e dhunës me armë, rritjen e kapaciteteve të burimeve njerëzore, si dhe në mjetet për kontrollimin dhe mbledhjen e armëve të vogla.

Kontrollimi i armëve të vogla dhe të lehta bëhet kur një vend ndalon apo kufizon zhvillimin, prodhimin, deponimin, riprodhimin, shpërndarjen apo përdorimin e AVL-ve. Kontrollimi i AVL-ve gjithashtu lidhet me traktatet dhe marrëveshjet bilaterale apo shumëpalëshe, andaj përmes implementimit të kësaj strategjie, Kosova edhe më tej do të përmbush përgjegjësinë e saj në atë fushë.

Arritje të dukshme janë bërë në fushën e kornizës institucionale, me krijimin e Departamentit për Siguri Publike që tani është plotësisht i gatshëm që të mbikëqyrë dhe zbatojë Ligjin për Armët, Ligjin për Shërbimet Private të Sigurisë, dhe Ligjin për Armë, Municion dhe Pajisje tjera të ngjashme për Institucionet Shtetërore të Sigurisë. Institucionet e para trajnuese janë licencuar dhe kanë ofruar trajnime teorike dhe praktike për të rritur sigurinë e përdoruesve të armëve.

Policia e Kosovës edhe më tutje po zbaton kornizën legjislative dhe bën konfiskimin e mbi 1500 armëve të zjarrit në vit.

Mekanizmat koordinues janë në vend, për të kontrolluar furnizimin me armë të zjarrit, duke përfshirë të gjitha institucionet e nevojshme, dhe këta mekanizma ofrojnë kontroll të plotë mbi depot legale në Republikën e Kosovës.

Megjithatë, sfidat mbeten dhe do të adresohen në këtë strategji të korrigjuar, ku ndër të tjera hyjnë: legalizimi dhe çaktivizimi i armëve të zjarrit në përputhje me ligjin për armët, që nuk ka filluar ende, rrjetet e krimit të organizuar ende janë duke trafikuar pistoleta me alarm dhe duke i konvertuar ato në armë vdekjeprurëse, dhe nevojiten më shumë të dhëna të hollësishme për këto armë por edhe për municionin në mënyrë që të participohet në çështjen e gjurmimit ndërkombëtarë të armëve ilegale dhe armëve ilegale të përdorura në krim.

Qasja themelore e programit nuk qëndron vetëm, dhe ne do të ndërlidhemi edhe me disa strategji tjera, si në veçanti: me Politikën mbi Sigurinë e Kosovës; me Strategjinë e Sigurisë së Komunitetit; me Strategjinë për Parandalimin e Krimit; dhe me Strategjinë mbi Krimin e Organizuar.

II. VIZIONI DHE MISIONI

Vizioni

Vizioni i kësaj strategjie është që Kosova do të jetë një mjedis i sigurt ku armët e vogla dhe të lehta janë nën kontroll.

Misioni

Misioni i kësaj Strategjie është vendosja e objektivave të përgjithshme, objektivave specifike dhe aktiviteteve që kanë të bëjnë me armët e vogla dhe të lehta (AVL) dhe çështjet e lidhura me to, si dhe të harmonizojë veprimet kombëtare dhe ndërkombëtare ndër-institucionale për arritjen e objektivave të përcaktuara në Strategji, e në veçanti:

1. Ndërtimi i kapaciteteve të mëtejme institucionale për mbikëqyrje të suksesshme dhe zbatim të rregullativave që kanë të bëjnë me AVL-të;
2. Zvogëlimi i krimit me armë dhe dhunës me armë në Kosovë;
3. Ndalimi i furnizimit ilegal të armëve dhe municionit në Kosovë;
4. Largimi i armëve dhe municionit ilegal që është në qarkullim në Kosovë;
5. Zvogëlimi i kërkesës për armë në shoqëri;
6. Promovimi i pjesëmarrjes së grupeve të shoqërisë civile (me fokus të veçantë përfshirjen e grave dhe grupeve të cenuara) në zhvillimin dhe zbatimin e politikave për kontrollimi të AVL-ve në parandalimin e dhunës, si dhe në strategjitë për çarmatim;
7. Zbatimi i rendit dhe ligjit, që të nxitet fuqizimi i komunitetit, dhe të mbështeten mundësitë për jetesë të qëndrueshme dhe ligjore në komunitetet më të prekura nga dhuna;
8. Mbështetja e sigurisë rajonale duke kontrolluar armët, mes aspekteve të tjera të krimit të organizuar transnacional; dhe
9. Zhvillimi i mëtejme i mekanizmave institucional për zbatimin e strategjisë për kontrollimin dhe mbledhjen e Armëve të Vogla dhe të Lehta në Kosovë.

III. METODOLOGJIA

Strategjia Kombëtare për Kontrollimin dhe Mbledhjen e Armëve të Vogla dhe të Lehta, është bazuar në parimet themelore që rrjedhin nga Kushtetuta e Kosovës, nga legjislacioni i aplikueshëm, nga instrumentet ligjore ndërkombëtare si dhe nga praktikat më të mira ndërkombëtare.

Posedimi ilegal i AVL-ve, dhe përdorimi i tyre ditorë, është një fenomen që ende ka nevojë për vëmendje shtesë. Është e obligueshme që të gjitha institucionet duhet të janë duke e zbatuar një përgjigje të integruar ndaj kësaj çështjeje, andaj, në përputhje me standardet ndërkombëtare, si organizatë kontrolluese, Qeveria ka emëruar Koordinimin Kombëtar dhe Sekretariatit brenda Ministrisë së Punëve të Brendshme.

Si përgjegjësi shtetërore, Kosova jep kontributin e saj në luftën ndërkombëtare kundër AVL-ve ilegale, dhe do të jetë e domosdoshme të rritet bashkëpunimi rajonal dhe ndërkombëtarë për gjurmim të armëve, si dhe të identifikohen autorët e krimeve të përfshirë në trafikim me AVL-të.

Për të siguruar sukses të mëtejme në zbatimin e kontrollimit të AVL-ve, kjo strategji më tutje duhet të zbatohet në nivel qendrorë dhe lokal. Strategjitë e kontrollimit të AVL-ve nuk janë të suksesshme pa mbështetjen e qytetarëve që zbatojnë ligjin. Rritja e vetëdijes së individëve, dhe e shoqërisë në përgjithësi, mundëson vendim-marrjen dhe llogaridhënien në lidhje me keqpërdorimin e AVL-ve.

Hartimi i kësaj strategjie kombëtare është përqendruar në përcaktimin e objektivave strategjike, në përgatitjen e mëtejme të stafit dhe në veprimet e përbashkëta të të gjitha institucioneve, që duhet të ndërmerren brenda katër viteve të ardhshme (2013-2016).

Duke parë kompleksitetin e çështjeve të lidhura me AVL-të dhe shkaqet e tyre rrënjësore, kjo strategji propozon 4 objektivat kryesore në vijim:

- 1. Do të ndalohen hyrjet dhe furnizimi ilegal përmes zbatimit të përmirësuar;*
- 2. Në vitin 2016, kërkesa për armë zjarri, municion dhe eksplozivë do të reduktohet për 20 përqind në popullsinë e Kosovës;*
- 3. Një hetim dhe dënim më efikas dhe më cilësorë i krimit me armë do të arrihet përmes bashkëpunimit më të mirë, koordinimit dhe ndihmës së ndërsjellë;*
- 4. Në vitin 2016, palët e interesuara do të kanë njohuritë, kushtet dhe burimet e nevojshme për të zbatuar metodat për kontrollim dhe mbledhje të përmirësuar të Armëve të Vogla dhe të Lehta.*

Objektivat specifike për këto 4 objektiva kryesore do të përshkruhen më vonë në këtë dokument.

IV. PARIMET E PËRGJITHSHME

Objektivat e parapara në këtë Strategji Kombëtare për Kontrollimin dhe Mbledhjen e AVL-ve dhe në Planin e Veprimit janë udhëzuar nga parimet në vijim:

4.1 Parimet e kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë

Strategjia e Kontrollimit dhe Mbledhjes së AVL-ve është bazuar në dispozitat e parashikuara në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, në legjislacionin në fuqi dhe në instrumentet ligjore ndërkombëtare.

4.2 Parimi i Mbrojtjes së të Drejtave të Njeriut

Kushtetuta e Republikës së Kosovës garanton të drejta për të gjithë qytetarët e Kosovës dhe në veçanti të drejta të grave dhe të fëmijëve, pavarësisht etnisë, gjinisë, moshës apo fesë.

Fëmijët dhe të rinjtë kanë të drejtë të jetojnë në një mjedis të mbrojtur nga keqpërdorimi i AVL-ve.

4.3 Parimi i Kujdesit Shëndetësorë

Trajtimi i individëve që kanë rënë viktimë e dhunës me AVL-të është i bazuar në parimin e kujdesit shëndetësorë të përshkruar në Ligjin për Shëndetësinë në Kosovë, në udhëzimet dhe në protokollet që janë në fuqi për shërbimin shëndetësorë në Kosovë.

4.4 Parimi i Garantimit të Sigurisë për të gjithë Qytetarët

Kushtetuta e Republikës së Kosovës garanton të drejtën për siguri dhe mbrojtje për të gjithë qytetarët. Ky parim gjithashtu i referohet rënies së niveli të krimit të lidhur me AVL-të.

4.5 Parimi i Vazhdimësisë

Kërkohet një përfshirje e vazhdueshme dhe gjithëpërfshirëse e të gjitha institucioneve dhe akterëve të ndryshëm për të luftuar këtë problem.

4.6 Parimi i Përfshirjes

Për momentin, keqpërdorimi i AVL-ve është një çështje me të cilën po ballafaqohet e tërë bota. Kjo çështje përhapet dhe prek të gjitha nivelet e shoqërisë, përfshirë komunitetin lokal, grupet, familjet dhe individët.

Parimi i përfshirjes ka të bëjë me përfshirjen e të gjitha institucioneve dhe mekanizmave të tjerë, si dhe të shoqërisë në përgjithësi, në trajtimin e kësaj çështjeje në nivel kombëtarë dhe ndërkombëtarë.

4.7 Parimi i Ndarjes së Përvojave dhe Përgjegjësive dhe Qasja e Përbashkët

Ky parim ka të bëjë me shkëmbimin e përvojave dhe praktikave më të mira, ndarjen e përgjegjësive në të gjitha nivelet, si dhe qasjen e përbashkët të miratuar nga të gjithë akterët për kontrollimin e AVL-ve.

4.8 Parimi i të Drejtës për t'u informuar

Ky parim ka të bëjë me të drejtën dhe obligimin për të informuar të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës për rreziqet dhe pasojat nga përdorimi i AVL-ve.

V. MEKANIZMAT LIGJORË

Në kontrollimin e armëve të vogla dhe të lehta, Republika e Kosovës ka në fuqi një bazë të gjerë legjislative, ku sa i përket legjislacionit primar, mund të përmenden në vijim, por nuk kufizohen vetëm në:

1. Kushtetuta e Republikës së Kosovës;
2. Kodi Penal i Kosovës;
3. Kodi i Procedurës Penale;
4. Ligji për Policinë;
5. Ligji për Ekzekutimin e Sanksionimeve Penale;
6. Ligji për Agjencinë Kosovare të Inteligjencës;
7. Ligji për Agjencinë Kosovare të Forenzikës;
8. Ligji për Pajisje me Armë, Municion dhe pajisje përkatëse të Sigurisë për institucionet shtetërore të Sigurisë;
9. Ligji për Tregtinë e Mallrave Strategjike;
10. Ligji për Shërbimet Private të Sigurisë;
11. Kodi i Drejtësisë për të Mitur;
12. Kodi Doganor dhe i Akcizave;
13. Ligji për Armë;
14. Ligji për Gjueti;
15. Ligji për Forcën e Sigurisë së Kosovës;
16. Ligji për Përdorim Civil të Eksplozivëve;
17. Ligji për Rendin dhe Qetësinë Publike;
18. Ligji për të huajt;
19. Ligji për Kontrollimin dhe Mbikëqyrjen e Kufirit Shtetërorë.

Edhe pse Kosova nuk ka nënshkruar apo ratifikuar konventa ndërkombëtare specifike lidhur me AVL-të, aktet a saj ligjore bazohen në instrumentet ligjore në vijim:

1. Direktiva e Këshillit 91/477/EEC e 18 qershorit 1991 për kontrollimin e blerjeve dhe posedimit të armëve;
2. Direktiva e Këshillit të BE-së 2008/51/EC që ndryshon Direktivën e Këshillit të BE-së 91/477/EC;
3. Pozicioni i përbashkët i BE-së 2003/468/CFSP i 23 qershorit 2003 për kontrollimin e **sekserëve të armëve**;
4. Kodi i sjelljes i BE-së për Eksportin e Armëve, 08 qershor 1998;
5. VEPRIMI I PËRBASHKËT I KËSHILLIT i 12 qershorit 2002 për kontributin e Bashkimit Evropian në luftimin e akumulimit destabilizues dhe shpërndarjen e armëve të vogla dhe të lehta, dhe shfuqizimin e Veprimit të Përbashkët 1999/34/CFSP (2002/589/CFSP);
6. POZICIONI I PËRBASHKËT I KËSHILLIT TË BE-së 2008/944/CFSP i 8 dhjetorit 2008 në përcaktimin e rregullave të përbashkëta që rregullojnë kontrollimin e eksportit të teknologjisë ushtarake dhe pajisjeve;
7. Protokollin i KB-së kundër prodhimit të paligjshëm dhe trafikimit me armë zjarri, pjesët e tyre, komponentëve dhe municionit, që plotëson Konventën e Kombeve të Bashkuara kundër krimit të organizuar transnacional;

8. Instrumenti Ndërkombëtarë i KB-së për t'u mundësuar shteteve identifikimin dhe gjurmimin, në kohë dhe në mënyrë të sigurt, të armëve të vogla dhe të lehta ilegale;
9. Programi i KB-së i veprimit për të parandaluar, luftuar dhe çrrënjësuar tregtinë me armë të vogla dhe të lehta ilegale, dhe me armë të lehta në të gjitha aspektet.
10. Vendimi i OSBE-së Nr. 8/04 Parimet e OSBE-së për kontrollimin e **sekserëve** me armë të vogla dhe të lehta;
11. VENDIMI I OSBE-së Nr. 5/04 Elementet standarde të certifikatave të përdoruesit të fundit dhe të procedurave verifikuese për eksportin e AVL-ve;
12. Dokumenti i OSBE-së për depot e municionit konvencional.

VI. OBJEKTIVAT KRYESORE dhe lidhja me Fushat Funktionale:

Objektiva 1: Hyrjet ilegale apo ekzistenca dhe furnizimi do të ndalohen përmes zbatimit të përmirësuar

Objektivat Specifike do të janë:

- 1.1. Legjislacioni i aplikueshëm për import, eksport dhe transit, përfshirë embargot dhe Kodin Evropian të Sjelljes për Eksport të Armëve, janë zbatuar me sukses;
- 1.2. Në vitin 2014, analiza e hollësishme në lidhje me armë të zjarrit, municion dhe eksplozivë do të përfundohet dhe shpërndahet;
- 1.3. Në vitin 2015, armët dhe municioni janë të dhënat primare që hyjnë në bazën e re të të dhënave ILP;
- 1.4. Lufta kundër posedimit ilegal dhe trafikimit me armë të zjarrit, municion dhe eksplozivë;
- 1.5. Në vitin 2014, të gjitha depot e armëve dhe municionit, duke zbatuar ligjin, të janë në përputhje me Udhëzimet Teknike të Municionit Ndërkombëtarë (UTMN).

Objektiva 2: Në vitin 2016, kërkesa për armë zjarri, municion dhe eksplozivë do të zvogëlohet për 20% në popullatën e Kosovës.

Objektivat specifike do të janë:

- 2.1. korniza relevante legjislative më tutje e zhvilluar dhe e ndryshuar sipas nevojës, përfshirë legjislacionin sekondarë.
- 2.2. Legjislacioni i armëve të zjarrit për kategorinë B, C dhe D1 në vazhdimësi të suksesshme;

Objektiva 3: Të sigurohet hetim më efikas dhe i një cilësie më të lartë, i krimit me armë, përmes bashkëpunimit, koordinimit dhe ndihmës reciproke;

Objektivat specifike do të janë:

- 3.1. Rritja e bashkëpunimit mes institucioneve për zbatim të ligjit dhe të drejtësisë;
- 3.2. Rritja e bashkëpunimit dhe shkëmbimit të informatave mes akterëve relevant për kontrollim të kufijve, që do të thotë policisë dhe doganave;
- 3.3. Lidhja e inteligjencës balistike mes Policisë së Kosovës dhe Agjencisë Kosovare të Forenzikës operative
- 3.4. Rritja e bashkëpunimit me partnerët rajonal;
- 3.5. Rritja e bashkëpunimit me institucionet ndërkombëtare;

Objektiva 4: Në vitin 2016, palët e interesit do të kanë njohuritë, kushtet dhe burimet e nevojshme për të zbatuar metodat e përmirësuara për kontrollimin dhe mbledhjen e Armëve të Vogla dhe të Lehta.

Objektivat specifike do të janë:

- 4.1. Përmbushja e kërkesave për trajnime themelore;
- 4.2. Përmbushja e kërkesave për trajnime të specializuara;
- 4.3. Kapacitetet teknike dhe teknologjike;
- 4.4. Kërkesa për gjurmim mund të trajtohet e sukses.

VII. MEKANIZMAT INSTITUCIONAL

Mekanizmi institucional ka të bëjë me rolin dhe koordinimin e aktiviteteve që rrjedhin nga Strategjia e Kontrollimit dhe Mbledhjes së AVL-ve, ku prioriteti kryesor i jepet Ministrisë së Punëve të Brendshme si e deleguar nga Qeveria, sipas vendimit të 23 majit 2007.

7.1 KOORDINATORI KOMBËTAR

Koordinator kombëtar, është personi përgjegjës, që ka mandat të koordinoj, drejtojë, monitorojë dhe raportojë për politikën e implementimit, aktivitetet dhe veprimet në lidhje me Strategjinë për Kontrollimin dhe Mbledhjen e AVL-ve.

Koordinatori kombëtar gjithashtu do të funksionojë edhe si Pikë Fokale Kombëtare mbi AVL-të për organizatat relevante ndërkombëtare.

7.2 Sekretariati

Është një trup i themeluar, që ka për funksion të mbledh informata dhe të dhëna nga institucionet tjera, të analizojë dhe të vlerësojë këto informata, si dhe të hartojë raporte analitike për koordinatorin kombëtar.

Për më tepër, detyrat e Sekretariatit janë t'i ndihmojë koordinatorit kombëtar në çështjet si në vijim:

- a) Të identifikojë, përcaktojë dhe (nëse është e mundur) kuantifikoj sasinë e ndikimit të AVL-ve në shoqëri, në sigurinë njerëzore, si dhe në zhvillimin ekonomik dhe social brenda fushës së tyre gjeografike të përgjegjësisë;
- b) Të përcaktojë qëllimin e ndërhyrjes së kontrollimit të AVL-ve brenda fushës së tyre gjeografike të përgjegjësisë;
- c) Të rrjedhin direktivat operative të ndërhyrjes së kontrollimit të AVL-ve nga qëllimi;
- d) Të zhvillojë dhe të shpërndajë një 'plan kombëtarë të veprimit për AVL-të';
- e) Të sigurojë disponueshmërinë e, dhe të mobilizojë kur nevojitet, burimet e mjaftueshme për të kryer planin kombëtarë të veprimit për AVL-të;
- f) Të miratojë propozimet e detajuara për ndërhyrje të AVL-ve, të të gjithë akterëve të duhur, duke përfshirë çështjet legislative, në mbështetje të planit kombëtarë të veprimit për AVL-të;

- g) Të koordinojë aktivitetet e të gjithë akterëve të duhur, në mbështetje të planit kombëtarë të veprimit për AVL-të;
- h) Të bëjë shpërndarjen e informatave me kohë, për të gjithë akterët e duhur, në mbështetje të planit kombëtarë të veprimit për AVL-të;
- i) Të monitorojë, sigurojë monitorimin e të gjithë komponentëve të ndërhyrjes së AVL-ve në mbështetje të planit kombëtarë të veprimit për AVL-të;
- j) Të vlerësojë komponentët e ndërhyrjes së AVL-ve në mbështetje të planit kombëtarë të veprimit për AVL-të;
- k) Të përditësojë planin kombëtarë të veprimit për AVL-të sipas nevojës, për t'ju përgjigjur ndryshimit të situatave operative;
- l) Të sigurojë raportimin e matjeve të ndërhyrjeve kombëtare të AVL-ve tek Departamenti i KB-së për Çështje të Çarmatimit (DÇÇ) në pajtim me Planin e Veprimit të KB-së për AVL-të;¹
- m) Të sigurojë raportimin e masave të ndërhyrjes kombëtare të AVL-ve tek OSBE-ja në pajtim me Dokumentin e OSBE-së për AVL-të;² dhe
- n) Të sigurojë që Protokollin e KB-së kundrejt Prodhimit Ilegal dhe Trafikimit të AVL-ve,³ Kodi i Sjelljes i KB-së⁴ dhe sanksionet e KB-së, janë hartuar për eksportin e AVL-ve.

7.3 Ministria e Punëve të Brendshme – Policia e Kosovës

MPB-ja ka një rol funksional në arritjen e objektivave specifike të përcaktuara në kuadër të kësaj strategjie. Ministria, përmes Policisë së Kosovës, ka autoritet të plotë në luftën kundër aktiviteteve ilegale duke përfshirë: përdorimin, blerjen, posedimin, shitjen, shpërndarjen, importin, eksportin, procedimin, kultivimin dhe prodhimin e AVL-ve, municionit dhe materialeve eksplozive.

Departamenti i Sigurisë Publike do të mbikëqyrë dhe të zbatojë ligjet që lidhen me AVL-të dhe është organ kompetent (organ ekzekutues) për tërë eksportin dhe importin në Kosovë si dhe për individët, për subjektet e biznesit dhe për Pajisjet për qëllime të veçanta. Mentorimi dhe kapaciteti vlerësues i tij është përgjegjës për rekomandimet adekuate, për drejtimin e Kontrollimit të AVL-ve dhe për strategjinë e mbledhjes.

Policia e Kosovës, së bashku me Doganat e Kosovës, janë institucione kufitare për parandalimin dhe luftën kundër aktiviteteve ilegale përgjatë kufijve Kosovar. Andaj, bashkëpunimi dhe koordinimi i tyre është thelbësorë për forcimin e kontrollit ndaj aktiviteteve ilegale që do të mund të dëmtonin sigurinë e Kosovës.

MPB-ja, dhe veçanërisht Departamenti për Sigurinë Publike do të bashkëpunojnë ngushtë me Ministrinë e Transportit për t'u sinkronizuar me Ligjin për Mallra të Rrezikshme.

¹ Programi i Kombeve të Bashkuara për veprim për të parandaluar, luftuar dhe zhdukur tregtinë ilegale të AVL-ve në të gjitha aspektet, korrik 2001.

² Dokumenti i OSBE-së për AVL-të, 24 nëntor 2000.

³ Protokollin e Kombeve të Bashkuara kundër fabrikimit ilegal dhe i trafikimit të armëve të zjarrit, pjesëve të tyre dhe komponenteve e municionit, duke plotësuar Konventën e Kombeve të Bashkuara kundër krimit të organizuar transnacional.

⁴ Kodi i Sjelljes i KB-së për Eksport të Armëve, 08 qershor 1998.

7.4. Roli i Ministrisë së Drejtësisë

Ministria e Drejtësisë është pjesë e rëndësishme e Kontrollimit Kombëtarë të AVL-ve dhe e Strategjisë së Mbledhjes, dhe roli i saj është të:

- Përforcojë sundimin e ligjit për të eliminuar posedimin ilegal të AVL-ve, dhe
- Komplettojë legjislacionin në fushën e zbatimit të ligjit, për të rritur efikasitetin në arritjen e qëllimeve të strategjisë për AVL-të që lidhen me kriminalitet;
- Përforcojë kapacitetet profesionale dhe teknike të Shërbimit Korrektues dhe Shërbimet e Provës në luftën kundër të gjitha fenomeneve negative në burgje dhe jashtë, për personat në provë.

7.5. Roli i Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave – Doganat e Kosovës

Doganat e Kosovës, si agjenci për zbatimin e ligjit nën përgjegjësinë e Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave, ka një rol në kontrollimin e të gjitha mallrave që hyjnë në dhe dalin nga Kosova.

Strategjia Kombëtare për Menaxhimin të Integruar të Kufijve dhe Plani i Veprimit ofron drejtimin që duhet të përcillet për të përforcuar bashkëpunimin dhe koordinimin mes këtyre dy organeve kryesore në luftën kundër përdorimit, tregtisë, transportit dhe prodhimit të AVL-ve ilegale, municionit dhe materialeve eksplozive.

7.6. Roli i Ministrisë së Shëndetësisë

Ministria e Shëndetësisë participon në ekzaminimin e aftësive mjekësore për posedim të armës në Kosovë, në pajtim me Ligjin për Armët.

MSh-ja ekzekuton këto aktivitete përmes institucioneve të caktuara shëndetësore dhe personelin e punësuar në to.

MSh-ja në mënyrë të vazhdueshme do të monitorojë aftësinë mjekësore të pronarëve të armëve dhe të informojë MPB-në kur një individ humb këtë aftësi, që provohet me kontroll mjekësor.

7.7. Ministria e Edukimit, Shkencës dhe Teknologjisë

Ministria e Edukimit, Shkencës dhe Teknologjisë merr pjesë në parandalimin e përdorimit të AVL-ve, përmes programeve të rregullta edukative, duke organizuar aktivitete kurrikulare dhe ekstra kurrikulare ku mund të përfshihen edhe prindërit dhe komuniteti.

Departamenti për zhvillimin e edukimit parauniversitar është përgjegjës për të zbatuar programet e rregullta dhe për të organizuar aktivitete ekstra kurrikulare, duke bashkëpunuar me Këshillin e Prindërve për Edukim të Kosovës në lidhje me kampanjat e ndryshme ndërgjegjësuese për të rinjtë nëpër shkolla.

7.8. Ministria e Tregtisë dhe Industrisë

Roli i Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, në bashkëpunim me Departamentin e Sigurisë Publike dhe Policinë e Kosovës, është të kontrollojë kompanitë e përfshira në tregtinë me AVL, municion dhe materiale eksplozive.

7.9. Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale

Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale do të bashkëpunojë me MPB-në për zbatimin adekuat të ligjit për Përdorim Civil të Eksplozivëve.

7.10. Ministria e Administrimit të Qeverisjes Lokale

Ministria e Administrimit të Qeverisjes Lokale do të ndihmojë dhe të advokojë për pjesëmarrje aktive të autoriteteve lokale drejt implementimit të kësaj strategjie.

7.11. Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinorë

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinorë do të bashkëpunojë me MPB-në në zbatimin dhe mbrojtjen e depove të eksplozivëve sipas IATG-së (Leja për Limitim të Eksplozivëve) apo veprimeve tjera që janë të dëmshme për mjedisin.

7.12. Zyra e Prokurorisë së Kosovës

Në pajtim me Kodin e Procedurës Penale dhe Ligjin për Zyrën e Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, Zyra e Prokurorisë së Kosovës do të kontribojë në zbatimin e kësaj strategjie, duke ju dhënë prioritet rasteve që lidhen me kryerjen e veprave penale, me krimin e organizuar të përfshirë në tregtinë me armë, me posedimin ilegal, me kontrollimin apo me përdorimin e paautorizuar të armëve si dhe transaksioneve.

7.13. Zyra e Statistikave të Kosovës

Zyra e Statistikave të Kosovës, do të bashkëpunojë me MPB-në për të siguruar informata statistikore efikase për lëndimet që lidhen me AVL-të, sipas standardeve të OBSH-së.

7.14. Ministria e Forcës së Sigurisë së Kosovës

MFSK-ja do të bashkëpunojë në zbatimin e aktiviteteve të parapara nga kjo strategji, e që janë në pajtim me kornizën ligjore të FSK-së.

7.15. Ministria e Punëve të Jashtme

Ministria e Punëve të Jashtme, në bashkëpunim me MPB-në do të sigurojë implementim adekuat të embargos dhe Kodit Evropian të Sjelljes për Eksportin e Armëve.

Ministria e Punëve të Jashtme, gjithashtu, do të jetë agjenci ekzekutive për të aprovuar dhe për t'u dërguar raportin e progresit organizatave ndërkombëtare relevante për kontrollimin e AVL-ve.

7.16. Agjencia Kosovare e Inteligjencës

Agjencia Kosovare e Inteligjencës do të bashkëpunojë në implementimin e kësaj strategjie rreth aktiviteteve të lidhura me krimin e organizuar dhe me AVL-të si kërcënim direkt për sigurinë shtetërore.

7.17. Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural

Roli i Ministrisë së Bujqësisë është që të jetë përgjegjëse për kontrollimin e armëve që janë pronë e Rojeve të Pyjeve si dhe të mbikëqyrë zbatimin e Ligjit për Gjueti.

7.18. Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit

MKRS-ja mbështetë zbatimin e kësaj Strategjie përmes zbatimit të Planit të Veprimit të Rinisë dhe zbatimit të politikave për armët në muze, si dhe zbatimit të standardeve për Shoqatat e Shenjëtarisë.

7.19. Agjencia e Kosovës për Forenzikë (AKF)

AKF-ja mbështet zyrën e prokurorit dhe Ministrinë e Punëve të Brendshme në pajtim me ligjin relevant. Për më tepër, do të bashkëpunojë ngushtë me policinë e Kosovës në fushën e mbledhjes së inteligjencës lidhur me armët e zjarrit dhe municionin.

VIII. BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTARË

Prodhimi i AVL-ve, shpërndarja; shndërrimi dhe përdorimi janë çështje për të cilat kërkohet bashkëpunim i institucioneve dhe organizatave, rajonale dhe globale, në nivel partneriteti.

Me këtë strategji ne synojmë që të krijojmë kushte për të adresuar AVL-të ilegale, në bashkëpunim me Institucionet Evropiane si dhe integrimin më të hershëm të mundshëm në Bashkimin Evropian. Kërkohet bashkëpunim reciprok mes institucioneve të Kosovës dhe institucioneve tjera ndërkombëtare të përfshira në parandalimin, luftimin dhe kontrollimin e AVL-ve.

IX. ZBATIMI I STRATEGJISË, MONITORIMI DHE VLERËSIMI

9.1 Roli i sistemit monitorues

Procesi i implementimit të strategjisë do të përfshijë arritjen e objektivave strategjike, objektivave specifike dhe aktiviteteve. Monitorimi dhe vlerësimi i rezultateve të zbatimit të objektivave dhe të efikasitetit të aktiviteteve përkatëse, do të janë pjesë përbërëse të procesit të Strategjisë dhe të komponentëve kryesorë të dërgimit të saj. Monitorimi dhe vlerësimi do të ofrojnë mjete për të matur progresin në lidhje me objektivat e përmendura, për të vlerësuar nevojën për krijimin e drejtimit të rregullave, e në veçanti të aktiviteteve. Procesi i monitorimit do të bëhet nga institucionet përgjegjëse me pjesëmarrje të gjerë nga akterët.

Dimensionet kryesore të monitorimit dhe vlerësimit të strategjisë janë:

- Kapacitetet institucionale;
- Indikatorët e performancës;
- Burimet informative dhe instrumentet matëse;
- Shpërndarja dhe përdorimi i rezultateve të monitorimit dhe vlerësimit.

9.2 Kapacitetet Institucionale për Monitorim dhe Vlerësim

Sistemi monitorues dhe vlerësues do të mbulojë të gjitha institucionet përgjegjëse për zbatimin e objektivave të definuara në Strategji dhe Plan të Veprimit.

- Ministria e Punëve të Brendshme, si institucion udhëheqës në zbatimin e strategjisë, do të themelojë Njësinë për Monitorim dhe Vlerësim sipas Koordinatorit Kombëtar të AVL-ve. Kjo njësi do të monitorojë indikatorët më të rëndësishëm në lidhje me AVL-të dhe do të përgatis një raport progresi mbi rezultatet e zbatimit të objektivave.
- Ministritë e linjës do të raportojnë mbi monitorimin dhe vlerësimin e aktiviteteve të caktuara për këto ministri apo për institucionet që janë në vartësi të tyre, përfshirë zyrat e prokurorit dhe gjykatat. Këto institucione, do t'i paraqesin raporte periodike Koordinatorit Kombëtar për të siguruar raportim koherent.
- Organizatat joqeveritare duhet të marrin pjesë në monitorim dhe në vlerësim, në diskutime të përbashkëta në tryeza të rrumbullakëta të lehtësuara nga Koordinatori.

9.3 Përzgjedhja e Indikatorëve për Monitorim dhe Vlerësim Indikatorët final

1. Numri i ligjeve dhe akteve nënligjore përkatëse, që janë zbatuar me sukses pas miratimit të Strategjisë;
2. Strukturat e themeluara
3. Numri i marrëveshjeve bilaterale dhe multilaterale të nënshkruara me shtetet tjera;
4. Monitorimi i strategjisë dhe raportet e vlerësimit,
5. Përqindja e popullatës që është vetëdijesuar për çështjen e keqpërdorimit të AVL-ve,
6. Përqindja e kërkesës për armë,
7. Kurrikulumi dhe numri i librave shkollorë që adresojnë AVL-të,
8. Numri i rasteve të lidhura me AVL-të të trajtuara në aspektin mjekësorë,
9. Numri i AVL-ve ilegale të mbledhura;
10. Numri i incidenteve të paraqitura, të dhunës me armë;
11. Çmimi në rrugë të një arme ilegale;
12. Mesatarja e dënimeve dhe e masave shtesë të konfiskimit të AVL-ve, për autorët e krimit;
13. Numri i rasteve të trajtuara nga Policia, Prokuroria dhe Gjykatat.
14. Numri i aktiviteteve ekstra kurrikulare të zbatuara.

9.4 Indikatorët e ndërmjetëm

Indikatorët e ndërmjetëm janë shfrytëzuar në aktivitetet monitoruese të caktuara në Planin e Veprimit për kontrollimin e AVL-ve.

9.5 Instrumentet Monitoruese dhe Vlerësuese

1. Mbledhja e standardizuar e të dhënave dhe sistemi i procedimit;
2. Të dhënat administrative, statistikore nga MPB-ja (Policia), MD-ja, MSh-ja, MEF-ja (Doganat, Administrata Tatimore e Kosovës), MASHT-i, Prokuroria, Gjykatat, MPMS-ja;
3. Mekanizmat referues kombëtarë dhe ndërkombëtarë;
4. Anketat dhe vërtetimet që synojnë vetëdijesimin e popullit në lidhje me çështjen e AVL-ve.

9.6 Shpërndarja dhe përdorimi i rezultateve të monitorimit dhe vlerësimit

Rezultatet e monitorimit dhe vlerësimit duhet të shpërndahen me qëllim që të shpallet progresi i bërë në kontrollimin dhe mbledhjen e AVL-ve. Sapo të hartohen raportet e progresit me të dhëna dhe vëzhgime, ato do të shpërndahen për përdoruesit, ku përfshihen, por nuk limitohen në:

1. Institucionet qendrore dhe lokale,
2. Partnerët ndërkombëtarë,
3. Shoqërinë civile,
4. Mediet
5. Publikun e gjerë.

X. PLANI I VEPRIMIT

Plani i Veprimit do të hartohet brenda kornizës së përgjithshme strategjike të definuar nga Kontrollimi Kombëtarë i Armëve të Vogla dhe nga Strategjia e Mbledhjes.

Plani i veprimit për ekzekutim të strategjisë do të përbëhet nga:

- Objektivat e përgjithshme;
- Objektivat specifike;
- Aktivitetet konkrete për arritjen e objektivave,
- Përcaktimi i institucioneve përgjegjëse dhe mbështetëse për arritjen e çdo objektivave dhe aktiviteti;
- Saktësimi i kornizës kohore për arritjen e çdo objektivave;
- Përcaktimi i burimeve të nevojshme financiare për zhvillimin e aktiviteteve;

- Përcaktimi i indikatorëve të caktuar për secilën objektivë dhe aktivitet.

Plani i Veprimit duhet të jetë koherent me Kornizën e Përgjithshme të Strategjisë Kombëtare për Kontrollimin dhe Mbledhjen e Armëve të Vogla dhe të Lehta të Republikës së Kosovës.

Marrëveshjet Ndërkombëtare më Relevante

Korniza e punës apo instrumenti	Përmbledhje	Veprimi i Kërkuar
Protokolli i KB-së për Armë të Zjarrit ⁵	Ky është dokumenti i parë i madh për AVL-të i miratuar në KB. Ky protokoll plotëson Konventën 2001 të KB-së kundër Krimit të Organizuar Transnacional. Në masat e përcaktuara në Protokollin KB-së për Armët e Zjarrit përfshihet: <input checked="" type="checkbox"/> Përforcimi i legjislacionit kombëtarë; dhe <input checked="" type="checkbox"/> Shkëmbimi i zgjeruar i informatave mes qeverive për armët ilegale të zjarrit, tregtarët e tyre, burimet dhe rrugët e trafikimit.	Ratifikimi
Programi i Veprimit i KB-së për AVL-të ⁶	PV i KB-së adreson një shtrirje më të gjerë të AVL-ve se sa Protokolli i KB-së për Armë Zjarri, dhe gjithashtu ka të bëjë me transferimet prej shteti në shtet të AVL-ve. Ai parashikon sferat e veprimit kundër AVL-ve në nivel ndërkombëtarë, rajonal, kombëtarë dhe lokal, dhe bën thirrje për një bashkëpunim më të afërt në mes të shteteve për të arritur qëllimet e caktuara, përfshirë ndarjen e informatave, ndihmën dhe vendosjen e standardeve dhe nënvizon rolin e organizatave rajonale në nxitjen e këtij bashkëpunimi. Qeveritë janë angazhuar që të takohen çdo dy vite për të shkëmbyer informata rreth zbatimit të tyre të PV-së.	Bashkëngjitja
Dokumenti i OSBE-së për AVL-të ⁷	Dokumenti i OSBE për AVL-të njeh kontributin e akumulimeve destabilizuese të AVL-ve që janë bërë në konfliktet e fundit në rajon. Ndan detyrat për të luftuar përhapjen e AVL-ve në disa kategori të normave dhe masave, dhe parasheh një rol potencial për misionet dhe zyrat fushore në zbatimin e tij. Në këto kategori përfshihen: <input checked="" type="checkbox"/> Rregullativat kombëtarë për AVL-të, përfshirë kontrollimet rreth fabrikimit, shënjimit dhe mbajtjes së regjistrit; <input checked="" type="checkbox"/> Monitorimi dhe rregullimi i tregtisë ndërkombëtare me AVL-të , përfshirë rregullat për ndërmjetësim, kriteret për eksport të përbashkët, kontrollimet e transferimit dhe shkëmbimin e informatave; dhe <input checked="" type="checkbox"/> Mbledhja e armëve, menaxhimi i depove dhe shkatërrimi i tepicave – thelbësore për reduktimin e akumulimeve destabilizuese dhe përhapjen e pakontrolluar të armëve të vogla, dhe parandalimin e trafikimit ilegal.	Bashkëngjitja
Dokumenti i OSBE-së për Rezervat e Municionit Konvencional ⁸	Dokumenti i OSBE-së për Rezervat e Municionit Konvencional ishte miratuar në vitin 2003 dhe plotëson Dokumentin e OSBE-së për AVL-të. Marrëveshja përfshinë të gjitha kategoritë e municionit konvencional, të materialit eksploziv dhe të mjeteve shpërthyesë, përfshirë municionin e armëve të rënda, karburanteve për predha dhe raketa, granata, siguresa. Dokumenti ofron procedurat dhe mekanizmat praktik për shkatërrimin e këtyre rezervave të tepërta. Qëllimi kryesorë është që shteteve anëtare t'u mundësohet forcimi i kapaciteteve të tyre kombëtare që të mund të trajtojnë problemet specifike vet, kurdo që të jetë e mundur në asetet e tyre.	Bashkëngjitja

⁵ Protokolli kundër fabrikimit ilegal dhe trafikimit të armëve të zjarrit, pjesëve të tyre, komponenteve dhe municionit, duke plotësuar Kombet e Bashkuara. Konventa kundër Krimit të Organizuar Transnacional (Protokolli I armëve të zjarrit). (Hyri në fuqi më 3 qershor 2005).

⁶ Programi i Veprimit i Kombeve të Bashkuara për të parandaluar, luftuar dhe zhdukur tregtinë ilegale me armë të vogla dhe të lehta në të gjitha aspektet. (Dokumenti I KB-së A/CONF.192/15). Korrik 2001.

⁷ Dokumenti I OSBE-së për Armë të Vogla dhe të Lehta. (FSC.JOUR/314). 24 nëntor 2000

⁸ Dokumenti I OSBE-së për rezervat e municionit konvencional. (FSC.DOC/1/03). 19 nëntor 2003.

Vendimi i OSBE-së për sistemet e mbrojtjes ajrore të manovrueshme (MANPADS) ⁹	Vendimi i OSBE-së për MANPADS-së miraton parimet për kontrollim të rritur të eksportit të MANPADS-ve, që janë nxjerr nga marrëveshja Wassenaar 'Elementet për Kontrollim të Eksportit të Sistemeve të mbrojtjes ajrore të manovrueshme'.	Bashkëngjitja
Vendimi i OSBE-së për Certifikata e Përdoruesit të Fundit ¹⁰	Ky vendim rikonfirmon angazhimet e Shteteve pjesëmarrëse të vëzhgojnë, si një nga standardet kryesore për të mbështetur dokumentacionin e eksportit, që asnjë leje për eksport pa një certifikatë të vërtetuar të përdoruesit të fundit nuk është lëshuar, apo ndonjë formë tjetër të autorizimit zyrtarë të lëshuar nga Shteti pranues. Vendimi mbulon kërkesat e dokumentacionit dhe mekanizmave të Certifikatës së Përdoruesit të Fundit.	Bashkëngjitja
Vendimi OSBE-së për Ndërmjetësim ¹¹	Ky vendim thekson parimet e dakorduara nga Shtetet, për të kontrolluar ndërmjetësimin e armëve në mënyrë që të shmanget anashkalimi i sanksioneve të miratuara nga Këshilli i Sigurimit të Kombeve të Bashkuara; vendimet e marra nga OSBE-ja, përfshirë kriteret e caktuara në nenin II A të Dokumentit të OSBE-së për AVL-të; marrëveshjet tjera për AVL-të, apo kontrollimet tjera të armëve dhe marrëveshjet për çarmatim, për të minimizuar rrezikun e devijimit të AVL-ve nëpër tregjet ilegale, inter alia, në duart e terroristëve dhe grupeve tjera kriminale; dhe për të rforcuar kontrollimin e eksportit të AVL-ve. Për të arritur këto objektiva, Shtetet pjesëmarrëse do të mundohen që të sigurojnë që legjislacioni i tyre ekzistues apo i ardhshëm për ndërmjetësim të armëve është në pajtim me dispozitat e përfshira në këtë dokument.	Bashkëngjitja
Veprimi i Përbashkët i BE-së për AVL-të ¹²	BE-ja përmes Veprimit të Përbashkët për luftën kundër akumulimit destabilizues dhe shpërndarjes së armëve të vogla, u ofron ndihmë financiare dhe teknike shteteve, grupeve të shteteve, organizatave ndërkombëtare dhe OJQ-ve të cilat kërkojnë mbështetje. Që nga viti 1999, përmes Aktit të Përbashkët, BE-ja ka miratuar 14 akte të tilla në Evropën Lindore, në Amerikën Latine, dhe në Karaibe, në Azi dhe në Afrikë. Në mesin e prioritetëve gjeografike të vendosura nga Këshilli i Evropës, vëmendje e veçantë i ishte dhënë shkatërrimit të rezervave ekzistuese të AVL-ve në Evropën Lindore dhe Juglindore, dhe akteve që mbështesin moratoriumet rajonale për armë të vogla në Afrikë.	Bashkëngjitja
Kodi i Sjelljes i BE-së për Eksportin e Armëve ¹³	Kodi i Sjelljes i BE-së paraqet një model për kontrollimin e eksporteve konvencionale ushtarake, që u paraqit nga Bashkimi Evropian si një angazhim politik në vitin 1998. Themelon kriteret e përbashkëta për aprovimin e eksporteve dhe parasheh dispozitat e transparencës si publikimi i Raportit Vjetor që i ofron shoqërisë civile si dhe komunitetit zyrtarë një mjet për të vlerësuar performancën e shteteve individuale. Kodi i sjelljes i BE-së po kalon rishikimin e tij të parë që synon të bëhet një pozitë ligjërishit detyruese e përbashkët e BE-së.	Bashkëngjitja
Strategjia e BE-së për Luftimin e Akumulimit Ilegal dhe Trafikimit të	Më 16 dhjetor 2005, Këshilli i Evropës miratoi një strategji për të mbështetur Veprimin e Përbashkët për AVL-të, në vitin 2002 (2002/589/CFSP). Strategjia është shkruar brenda kornizës së Strategjisë së Sigurisë Evropiane (2003), siç ishte strategjia e ngjashme për Armët e	Bashkëngjitja

⁹Vendimi i OSBE-së për Sistemin OSCE Decision on Man-Portable Air Defense Systems. (Decision No. 7/03). (FSC.DEC/07/03). 23 July 2003.

¹⁰ Vendimi i OSBE-së për Certifikatat e Përdoruesit të fundit dhe Procedurat Verifikuese për Eksportin e AVL-ve (Vendimi Nr. 05/04). (FSC.DEC/5/04). 17 nëntor 2004.

¹¹ Vendimi i OSBE-së për parimet e kontrollimit të ndërmjetësimit të AVL-ve. (Vendimi Nr. 08/04). (FSC.DEC/8/04). 24 nëntor 2004.

¹² Veprimi i përbashkët i Këshillit të BE-së për kontributin e Bashkimit Evropian në luftën kundër akumulimit destabilizues dhe shpërndarjes së armëve të vogla dhe të lehta dhe shfuqizimin e Veprimit të Përbashkët 1999/34/CFSP. (2002/589/CFSP). 12 korrik 2002.

¹³ Kodi i Sjelljes i BE-së për Eksport të Armëve, 08 qershor 1998.

AVL-ve dhe Mucionit ¹⁴	Shkatërrimit Masiv në vitin 2003. Synimi është të zhvillohet një <i>“qasje e integruar dhe një plan gjithëpërfshirës i veprimit për të luftuar tregtinë ilegale me AVL-të dhe municionin e tyre”</i> .	
Pozita e Përbashkët e BE-së për ndërmjetësim të armëve ¹⁵	Objektiva e Pozitës së Përbashkët është që të kontrollohet ndërmjetësimi me armë në mënyrë që të shmanget anashkalimi i embargove të armëve të KB-së, BE-së apo OSBE-së, si dhe i kriterëve të përcaktuara në Kodin e Sjelljes të BE-së. I obligon Shtetet anëtare të BE-së që të krijojnë një kornizë të pastër ligjore për aktivitete të ndërmjetësimi. Pjesë e kësaj kornize është sistemi licencues ku aplikacionet për licencë vlerësohen për transaksione të veçanta të ndërmjetësimi kundrejt dispozitave të Kodit të Sjelljes të BE-së. Pozita e përbashkët gjithashtu parashihet themelimin e një mekanizmi për shkëmbim të informatave për aktivitetet e ndërmjetësimi.	Bashkëngjitja
Pakti i stabilitetit i AVL-ve plani i zbatimit rajonal ¹⁶	Në nëntor të vitit 2001 Pakti i Stabilitetit për Evropën juglindore (SCSP) ¹⁶ hartoi një plan për zbatim rajonal (SP SAËL RIP) për të luftuar shtimin e Armëve të Vogla dhe të Lehta (AVL). Ky plan ishte rishqyrtuar në maj të vitit 2006. Në kontrast me shumë marrëveshje të tjera për kontrollim të armëve për t'u ndihmuar vendeve në zbatimin e angazhimeve dhe përfshirjen e këtyre qeverive në caktimin e prioritetëve dhe në vendim-marrje, në përpjekjet e gjëra rajonale. Këta mekanizma janë mbështetur apo zbatuar përmes SEESAC në nivel rajonal, dhe përmes disa iniciativave të mbështetura ndërkombëtarisht brenda shteteve individuale. 17 Në nivelin politik, SP SAËL RIP duhet të konsiderohet i suksesshëm, dhe ka ofruar një mandat të vlefshëm dhe efikas për të dhënë një përgjigje efektive në nivel operativ.	Bashkëngjitja

¹⁴ Strategjia e BE-së për të luftuar kumulimin ilegal dhe trafikimin e AVL-ve dhe municionit të tyre. Këshilli I Bashkimit Evropian 5319/06 i 13 janar 2006. (Miratuar 15 - 16 dhjetor 2005).

¹⁵ Pozita e përbashkët e Këshillit 2003/468/CFSP e 23 qershor 2003 për kontrollimin e ndërmjetësimi të armëve. OJ L 156, 25.05.2003, fq. 79-80.

¹⁶ Luftimi i shtimit të AVL-ve - Plan i zbatimit rajonal i Paktit të Stabilitetit për Evropën juglindore, 28 nëntor 2001. (Rkorigjuar në maj 2006). (eëë.stabilitypact.org).

